



ISOLOR HYBRID Aqua Plus+

Veshje elastomere poliuretani hibride, rezistente ndaj ujit, me përqindje të lartë ngurtësie



Rendimenti i mbulimit: 0,7 - 2 m²/kg në një shtresë, në varësi të aplikimit dhe sipërfaqes



Koha e tharjes: 1 - 3 orë



Hollimi: deri në 5 % për vëllim të holluar me ujë, ose deri në 10 % për mbulim bituminoz



Mundësia për shtresë të dytë: 8 - 12 orë



Paketimi: 750 ml, 3 lt, 10 lt



Aplikimi: Me furçë, rul, furçë për mure, spatul

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë elastomere hibride, rezistente ndaj ujit, e tretshme në ujë me përqindje të lartë ngurtësie me bazë akriliku të veçantë dhe rrëshire poliuretani (teknologjia HSH PUARC). Thahet dhe ngurtësohet shpejt. Krijon një membranë të depërtueshme nga avulli që është e padepërtueshme nga lagështira dhe uji i ndenjtur dhe ruan elasticitetin e saj nga -20 °C deri në + 80 °C. Mbulon plotësisht kapilarët dhe krijon çarje deri në 1,5 mm. Aftësi të shkëlqyera për të përballuar kontraktimet dhe shtrirjet. Falë përbërjes novatore të produktit, depozitimi i ndotësve parandalohet dhe kështu bardhësia dhe vetitë termoreflektuese ruhen për një kohë të gjatë. Mund të aplikohet në trashësi të madhe me një shtresë (1,5 kg/m²) duke reduktuar kostot e punës.

ISOLOR HYBRID AQUA plus ka certifikimin CE në përputhje me EN-1504-2, si produkt për mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit nga depërtimi, për kontrollin e lagështisë dhe rezistencë më të lartë specifike që kufizon përmbajtjen e lagështisë.

Gjithashtu, është i certifikuar si një material reflektues ndaj të ftohtit (CRES, DEMOKRITOS) dhe ofron një reflektim termik fantastik (reduktim i kostove të ftohjes gjatë muajve të verës). Është një zgjidhje e shkëlqyer me kosto efektive për ruajtjen e rezistencës ndaj ujit me ose pa përdorimin e shiritave me fibra qelqi apo përforsim me poliester. Aplikim dhe mirëmbajtje e thjeshtë (nga staf i specializuar ose pa përvojë) dhe miqësor ndaj përdoruesit dhe mjedisit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Graviteti specifik	1,50 - 1,54 kg/lt
Rendimenti i mbulimit dhe konsumi	<i>Përdorimi me rul: 1,25 - 2 m²/kg ose konsum 500 - 800 gr/m² & 0,5 - 0,8 kg/m² për shtresë, në varësi të fortësisë së sipërfaqes.</i> <i>Përdorimi i furçës së murit ose furçës me fije të buta dhe pistoletës për spërkatje pa ajër: 0,7 - 1 m²/kg ose konsumim 1 - 1,5 kg/m² për një shtresë të vetme.</i>
Hollimi	Nëse është e nevojshme, hollohet deri në 5 % me ujë. Për aplikim në pëlthurë bituminoze, veshja e parë është deri në 10 %.
Koha e tharjes	E thatë për tu prekur për 1 - 3 orë, në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së shtresës.
Mundësia për shtresë të dytë	Mund ta lyeni përsëri pas 8 - 12 orësh , në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së shtresës. Shtresa e dytë rekomandohet të aplikohet në drejtim të akrepave të orës. Mund të punoni mbi sipërfaqe 8 - 12 orë pas aplikimit dhe në varësi të kushteve të mjedisit.
Rezistenca ndaj ujit & alkalineve	Rezistenca ndaj ujit dhe alkalineve. Rezistencë e lartë ndaj ujit të ndenjtur.
Elasticiteti	Produkti ka veti elastike deri në 500% në një trashësi shtrese të thatë prej 500 µm dhe në një temperaturë prej 20 °C. Ka elasticitet të konsiderueshëm në temperatura nga -20 °C deri në 60 °C.
POA	"Bojëra për mure të jashtme me substrate minerale". Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 40 g/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 39 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikë vlimi < 250 °C.
Aplikimi	Aplikojeni me rul, spatul, furçë, furçë për mure ose furçë të trashë.
Ngjyrat	E bardhë, gështenjë.
Reflektimi në spektër të dukshëm:	R = 89,5 % ± 2 % (400-750 nm, ASTM E903-96)
Reflektimi në spektrin IR:	R=89,5 % ± 2 % (780-2500 nm, ASTM E903-96)
INDEKSI I REFLEKTIMIT (SRI)	108 (ASTM E 1980-01)
Koeficienti i emetimit:	0,88 (e, ASTM E408-71)
Ngjitja në sipërfaqe betoni:	>4 MPa (EN 24624)
Ngjitja në sipërfaqe betoni të lyer me bojë Isolor Hybrid Primer:	>6 MPa (EN 24624)
Elasticiteti në thyerje:	350 % në 23 °C dhe 100 % në -10 °C
Forca elastike	(23 °C/ -20 °C) N/mm ² = 1,4/ 7,5

Tabela 1

KONSUMI	KOHËZGJATJA E REZISTENCËS NDAJ UJIT (KOHËZGJATJA MINIMALE E VLERËSUAR E FUNKSIONIT TË REZISTENCËS NDAJ UJIT)	PËRDORIMI I PËRFORCIMIT ME POLIESTËR
1,0 kg/m ²	4 - 5 vjet	Aftësia për ta aplikuar në një shtresë të vetme
1,5 kg/m ²	5 - 7 vjet	"
2,0 kg/m ²	7-9 vjet	"
2,0 kg/m ²	9 - 10 vjet Përdorimi i përforcimeve: 50 gr/m ²	aplikimi i materialit në të paktën 3 shtresa.
4,0 kg/m ²	10-14* vjet Përdorimi i përforcimeve: 100 gr/m ²	
*Në varësi të llojit të përforcimit		



PRODUKT PËR MBROJTJEN E BETONIT KUNDËR DEPËRTIMIT (1,3) PËR KONTROLLIN E LAGËSHIRËS (2,2) DHE PËR RRRITJEN E REZISTENCËS SPECIFIKE DUKE KUFIZUAR PËRMBAJTJEN E LAGËSHIRËS 8,2)

DEPËRTUESHMËRIA E CO₂	Sd>50 m (EN 1062-6)
DEPËRTUESHMËRIA E AVUJVE TË UJIT	KLASA 1 (sd<5 m) (EN ISO 7783)
PËRTHITHJA E KAPILARËVE DHE DEPËRTUESHMËRIA E UJIT	W = 0,05 Kgr/m²*0,5 orë (<0,1 Kgr/m²*0,5 orë) (EN 1062-3)
REZISTENCA NDAJ SHKËPUTJES	> 0,8 N/mm² (EN 1542)
SUBSTANCAT E RREZIKSHME	SIPAS 5,3
REAGIMI NDAJ ZJARRIT	EUROKLASA F



PËRΓATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet e reja lyhen me astar ISOLOR Hybrid Primer ose Smaltodur të holluar me 70 % në hollues të bardhë. Sipërfaqet e vjetra: Ato lyhen me astar ISOLOR Hybrid Primer pas kruajtjes së pjesëve të shkëputura dhe riparimit të defekteve ose çarjeve me stuko elastike Smaltofill ose duke i zhytur në ISOLOR HYBRID Plus të shtuar me përforcues dhe/ose me ngjitës me poliuretane për nyjat.

APLIKIMI

Përziheni mirë. Në sipërfaqe të pastra dhe të thata, aplikoni ISOLOR HYBRID AQUA PLUS në mënyrë të njëtrajtshme në një ose në më shumë shtresa. Konsumi i një sasive më të madhe materiali për m² ndikon në kohëzgjatjen e rezistencës ndaj ujit (Tabela 1, në fund të fletëpalosjes teknike).

Nëse do ta shtoni me përforcues, materialin duhet ta aplikoni në 2 - 3 shtresa. Përforcimi i gjerësisë, p.sh. 1 m gjerësi, shtohet dhe integrohet në shtresën e parë të freskët. Shtresa e parë me përforcim mbulohet me një ose dy shtresa produkti shtesë.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini ato me ujë të ngrohtë me sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë. Mos i zbrazni ujërat që keni larë mjetet në ujërat nëntokësorë.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 °C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

SHËNIME

Më shumë informacion për etiketat e substancave të rrezikshme të produktit në përputhje me legjislacionin Evropian dhe atë kombëtar në fuqi mund të gjeni në Fletën e të Dhënave të Sigurisë (FDS) së produktit.

Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.